REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 103/17
Date/Datum 29.05.17
PRISHTINE - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 103/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej z. Ekrem Salihu - Kryetar, z.Tefik Sylejmani – Referues dhe z.Nuhi Paçarizi – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **"Dajaku Lux" - Gjakovë**, me nr. 103/17, kundër AK – Komuna Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish per nevojat e Komunes se Gjakoves" – Lot -1,** me nr. prok:**623/17/335/121**, në seancën e dt. **24.05.2017**, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** , ankesa e OE, **"Dajaku Lux"**, me nr. **103/17**, e parashtruar kundër AK – Komuna Gjakove, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish per nevojat e Komunes se Gjakoves" – Lot -1,** me nr. prok:**623/17/335/121,** si e bazuar pjesërisht.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues / Komuna Gjakove, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish per nevojat e Komunes se Gjakoves" – Lot -1,** me nr. prok:**623/17/335/121,** si i pa bazuar.

III. **Obligohet,** autoriteti kontraktues / Komuna Gjakove, qe proceduren e prokurimit me titull: **"Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish per nevojat e Komunes se Gjakoves" – Lot -1,** me nr. prok:**623/17/335/121,** ta **Anuloj**, dhe te njejtin ta ri-tenderoj nese edhe me tutje ka interes per te njejtin lot.

IV. Autoriteti Kontraktues në afatë prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

VI. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues **"Dajaku Lux"** janë te bazuara pjeserisht, konform nenit 118 të LPP-së i bëhet kthimmi i sigurimit të ankeses, megjithatë i njejtit OE, obligohen që në periudhën kohore prejë më së largu gjashtëdhjetë (60) diteve, të parashtrojnë kërkesë për tërheqje të mjeteve, në të kundërtën mjetet do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakove, më datën: 09.02.2017, ka publikuar njoftim për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish per nevojat e Komunes se Gjakoves"**, me nr. prok:**623/17/335/121**.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjëshëm me çmim më të ulët.

Kundër njoftimit për dhënje të kontratës ne lot 1, operatori ekonomik, **"Dajaku Lux"** - Gjakove, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesave, në bazë të nenit 113.1, të LPP-ës nr.04/L-042, më datën.18.04.2017, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së,z.Visar Bibaj , për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankuese.

Eksperti shqyrtues, më datën. 24.04.2017, i dorëzon Panelit Shqyrtues raportin e ekspertizës , ku në raportin e tije ka shqyrtuar – trajtuar pretendimet ankimore te perfshira ne ankese, njëkohësisht kane rekomanduar dhe propozuar qe loti i 1, i ankimuar te Anulohet ne teresi ndersa ankesa te aprovohet si e bazuar pjeserisht.

Autoriteti kontraktues / Komuna Gjakove, përmes parashtresës me shkrim të dt. 26.04.2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 24.04.2017, ndersa OE . "Dajaku Lux", me daten 25.04.2017, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertizes.

Gjatë seances se shqyrtimit te dates 24.05.2017, e cila u mbajt pa prezencen e paleve konform nenit 26, paragrafi 1, te rregullores se punes se OSHP-se, ku ishin prezent anetaret e panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lendes duke e bere kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit, rrjedhimisht paneli shqyrues konstatoi se pretendimet ankimore te parashtruesit te ankeses jane te qendrueshme pjeserisht per faktin se kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate nuk janë identike siq parashifet ne paragtafin 4, te nenit 27, te LPP-se, gjegjesisht ne dosje te tenderit , periudha e sigurimit te tenderit eshte kerkuar ne 4 muaj, perderisa e njejta kerkese ne njoftim per kontrate është 3 muaj.

Pra Autoriteti kontraktues me rastin e njoftimit për dhënie të kontratës nuk ka respektuar nenin 7 , 27 dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE :
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për çështje
Administrative për kompensim dëmi në afat prej
30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – Ankuesve
1x1 ekzemplar - Autoriteti Kontraktues
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Ekrem Salihu